

VENDIM
Nr. 114, datë 13.2.2020

PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA VLORË, TË NJË PJESE TË TRUALLIT FUNKSIONAL BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 912, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Vlorë, të një sipërfaqeje truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 400 (katërqind) m², nga truall funksional i pronës nr. 912, me emërtim “Shtëpia e ushtarakëve”, me vendndodhje në Vlorë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planrilevimit, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për nevoja urbanistike, ndërtim rruge publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 912, me emërtim “Shtëpia e ushtarakëve”, me vendndodhje në Vlorë. Sipërfaqja truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 400 (katërqind) m², pjesë e pronës, sipas planrilevimit, të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të Bashkisë Vlorë, miratuar me vendimin nr. 639, datë 29.9.2007, të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë Vlorë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Vlorë për ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1358679

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. VLORE Zona Kadastrale Nr. 8605
Numri i Pasurisë 50/17 Volumi 12 Faqe 88
Adresa e Pasurisë VLORE
Lloji i Pasurisë TRUALL
Sipërfaqja Totale 1673.00 m2
Nga kjo : Sa Truall 1,673.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 795.00
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
SHIET			1/1	VLORE

- është pronar i pasurisë me numër 50/17
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuari (t)
më datë 22/2/2017 Nr. 4709

Data e lëshimit të çertifikatës

2/3/2017

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

(REZART ELMAZI)

PLAN RILEVIMI
Prona nr.912 Shtëpia e Ushtarakëve Vlorë

MIRATOHET
DREJTORI I SH.Q. TË FA
Në mungesë
KRYETARI I DEGËS EKONOMIKE
ELIDA LEKA

ZV/DREJTORI I HGJIU
Ark. Enë SINOIMERI

IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 8605
Nr.Pasurise Vol. Fq
Indeksi i Hartes K-34-123-(160-B)
VL-GJ-11
Shkalla 1: 500
Adresa e pasurise L. "28 Nëntori", Vlorë
Q/F Vlorë
Pronari: Ministria e Mbrojtjes, Shtëpia Qëndrore e FA

Hartoi
Ing. Ermal MACI

Gusht 2019

- Shpjeguese:
- Sip. e përgjithshme = 1673 m²
 - Sip. e zënë nga rruga (trotuari) = 400 m²
 - Sip.që ngelet prones = 1273 m²
 - Sip.e përgjithshme nën objekt = 797.5 m²

